

Titulli i lëndës:

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Sociolinguistikë
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Bachelor, Semestri VII
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	Departamenti i Gjuhës Shqipe, Fakulteti i Filologjisë Sipas orarit.
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Shkumbin MUNISHI
Të dhënat kontaktuese:	shkumbin.munishi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda mësimore përqendrohet në studimin e dukurive gjuhësore në kuadrin shoqëror. Në këtë lëndë paraqiten njohuri të përgjithshme për studimet sociolinguistike dhe ofrohen informata themelore e konceptore lidhur me studimet sociolinguistike.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i këtij kursi është që studentët të njihen me format e studimeve gjuhësore në raport me bashkësitë shoqërore. Është me rëndësi që studentët të kuptojnë ndikimin e faktorëve shoqërore në ligjërime dhe të jenë në dijeni për varietetet e ndryshme gjuhësore që ekzistojnë në kuadër të një bashkësie shoqërore dhe në këtë kuptim të njihen edhe me variacionin gjuhësor të gjuhës shqipe. Duke u bazuar në studimet e ndryshme sociolinguistike të nxjerra nga përdorimi i gjuhës, ky kurs fokusohet në atë se si gjuha konstrukton dhe i reflekton strukturat e ndryshme shoqërore dhe ndikimin e tyre në gjuhë, si dhe rolin e faktorëve shoqëror në përcaktimin e formës së ndërkomunikimit njerëzor.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë në gjendje që: - T'i njohin konceptet themelore nga fusha e sociolinguistikës dhe të njihen me problemet themelore të sociologjisë së gjuhës shqipe - Të jenë në gjendje ta kuptojnë se si funksionon gjuha dhe të folurit në kuadër të bashkësive shoqërore dhe të bashkësive folëse dhe ta kuptojnë rëndësinë e gjuhës në ndërveprimin shoqëror, si dhe të kuptojnë se si është e shtresuar dhe si funksionon gjuha shqipe në kuadër të bashkësisë shqiptare. - T'i njohin implikimet e çështjeve gjuhësore në çështje të tjera shoqërore, politike e kulturore. - T'i njohin varietetet e ndryshme të gjuhës shqipe, krahas gjuhës standarde, dhe ta njohin historinë e procesit të standardizimit të shqipes.

- T'i njohin metodat e studimeve sociolinguistike të ligjërimit dhe të jenë në gjendje të bëjnë hulumtime të kufizuara të natyrës sociolinguistike

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori / Punë në laborator / Ushtrime	1	15	15
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	12 minuta për student në javë	15	12 x 15 = 180, 3 orë
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	3	6
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	5		5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.			
Totali			90.00 orë 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies: Ligjërata, ushtrime, seminare dhe detyra.

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i parë: 25%
Vlerësimi i dytë: 30%
Detyrat e shtëpisë : 10%
Vijimi i rregullt: 5%
Provimi final: 30%
Total: 100%

Literatura primare:

Richard A. Hudson, Sociolinguistika, Dituria, Tiranë, 2002.

Janet Holmes, Hyrje në sociolinguistikë, Botimet Pegi. Tiranë, 2015.

Rexhep Ismajli; Bardh Rugova; Shkumbin Munishi, Leksikon i termave të sociolinguistikës. ASHAK. Prishtinë. 2020.

Rexhep Ismajli, “Në gjuhë” dhe “për gjuhë”, Dukagjini, Pejë, 1998.

Rexhep Ismajli, Standarde dhe identitete, Dukagjini, Pejë, 2003.

Rexhep Ismajli, Bashkësi, njësi, varietet. ASHAK. Prishtinë. 2019.

Shkumbin Munishi, Probleme të shqipes standarde në Kosovë. ZeroPrint. Prishtinë. 2013.

	Shkumbin Munishi. Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për shqipen standard. ZeroPrint. Prishtinë. 2013.
	Fadil Raka, Historia e gjuhës letrare shqipe, Tetovë, 1997.
Literatura shtesë:	Ronald Wardhough, An Introduction to Sociolinguistics. Blackwell Publishing. 2006.
	Trudgill Peter, Sociolinguistics – An Introduction to language and Society, Fourth Edition, First Published in Pelican Books 1974, Penguin Books, 2000.
	Byron, Janet. Selections Among Alternates in Language Standardization – The Case of Albanian, Mouton The Hague, Paris, 1976.
	Sociolinguistics – A Reader, Edited by Nikolas Coupland and Adam Jaworski, St. Martin's Press, New York, 1997.

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Çka është sociolinguistika; sociolinguistika dhe gjuhësia; zhvillimi sociolinguistik i fëmijës.
Java 2:	Gjuha dhe shoqëria; bashkësitë shoqërore, bashkësitë gjuhësore dhe bashkësitë komunikuese, njësitë gjuhësore dhe ndërlidhja e tyre shoqërore.
Java 3:	Varietet gjuhësore – gjuhët, dialektet, sociolektet dhe regjistrat.
Java 4:	Gjuhët standarde dhe formimi i tyre; standardizimi i gjuhëve ballkanike (shembuj).
Java 5:	Varietetet gjuhësore të shqipes; histori e shkurtër e standardizimit të shqipes.
Java 6:	Menaxhimi i gjuhës dhe rishikimi i normës.
Java 7:	Kontaktet gjuhësore, ndërrimi i kodit dhe ndryshimi i stilit, diglosia dhe bilinguizmi, gjuhët pixhinë dhe kreole.
Java 8:	Gjuha, kultura dhe mendimi.
Java 9:	Të folurit si bashkëveprim shoqëror.
Java 10:	Studimi sasior i ligjërimit dhe metodologjia studimore në sociolinguistikë
Java 11:	Shembuj të studimeve sasiore të ligjërimit (studimet e Labov, Trudgill, Milroy, Coupland)
Java 12:	Pabarazia gjuhësore dhe pabarazia shoqërore.
Java 13:	Roli i faktorëve shoqëror në përshtatjen e të folurit, përshtatja gjuhësore dhe audience design
Java 14:	Gjuha dhe gjinia, dallimet gjuhësore midis meshkujve dhe femrave
Java 15:	Sintezë e problemeve të diskutuara dhe ripërmbledhje e lëndës.

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët duhet t'i ndjekin me rregull ligjëratat. Në rast të mungesave të shumta të paarsyeshme studentëve nuk do t'u verifikohet pjesëmarrja e rregullt në ligjëratat e ushtrime. Prania e studentëve në ligjëratat dhe në ushtrime shënohet në fletët e evidencës dhe me regjistrim elektronik të pranisë.

Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave dhe provimeve.